



**Republika e Kosovës – Republika Kosova**  
*Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrresa*  
*Izborni Panel za Žalbe i Predstavke*

**Anr.870/2021**

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrresa (PZAP)**, i përbërë nga gjyqtaret: Adnan Konushevci kryesues, Zyhdi Haziri, Ferki Xhaferi anëtar, duke vendosur përkitazi me apelin e kandidatit për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Podujevës Mimoza Abdullahu nga Subjekti Politik Partia Demokratike e Kosovës, me seli në Prishtinë, dega në Komunën e Podujevës, paraqitur kundër vendimit me numër 2948-2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, për Kuvendin Komunal, në seancën e panelit të mbajtur më datë 06.11.2021, mori këtë:

#### **V E N D I M**

**Hudhet i palejuar** apeli Anr.870/2021 i datës 03.11.2021, i paraqitur nga Mimoza Abdullahu, nga Podujeva, Kandidate për Kuvend Komunal nga Partia Demokratike e Kosovës, i paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), Nr.2948-2021, i datës 03.11.2021, për Shpalljen e Rezultateve përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021.

#### **A r s y e t i m**

PZAP-i, më datë 04.11.2021, ka pranuar apelin Anr.870/2021, të paraqitur nga Mimoza Abdullahu, nga Podujeva, Kandidat për Kuvend Komunal nga Partia Demokratike e Kosovës, me të cilin kërkon që të bëhet rinumërimi, i vendvotimeve 1824E/13R, në FKR shihet qartë tendenca tek nr.7 i kandidatës ku aty nuk dihet qartë se sa është rezultatit 9 apo 6, në vendvotimin 1832E/01, në FRK nga 5 anëtarë të KVV-së një anëtarë nuk është nënshkruar, ndërsa në vendvotimin 1837E/01, nuk janë numëruar saktë votat të subjektit politik AAK, ndërsa në vendvotimin 1812E/01 nuk është publikuar FKR-ja në Web faqen e KQZ-së ku në vend të saj është FKR-ja e vendvotimit 1812/02.

PZAP-i, pas shqyrtimit të apelit, vlerësimit të pretendimeve ankimore, dhe në kuptim të nenit 105 paragrafi 1, dhe nenit 117 paragrafët 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

### **Apeli është i palejuar**

Paneli pas shqyrtimit të shkresave të lëndës gjeti se apeli i parashtruar nga Mimoza Abdullahu, nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës, dega në Komunën e Podujevës, ka njëjtësi subjektive, objektive, gjendje të njëjtë faktike me apelin e parashtruar nga Xhevdet Maloku kandidat për Kuvend Komunal në Komunën e Podujevës, të paraqitur me datën 04.11.2021 dhe është vendosur me vendimin e PZAP-it Anr.848/2021 të datës 05.11.2021.

Meqenëse për rastin në fjalë është vendosur me vendimin e PZAP-it, Anr.848/2021 të datës 05.11.2021, dhe pasi që për të njëjtën çështje është vendosur në vendimin e lartcekur paneli nuk u lëshua fare në shqyrtim të kësaj çështje të theksuar në ankesë.

Paneli, duke u bazuar në arsyet e cekuar më lartë e po ashtu në pajtim me dispozitat e nenit 6.4 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it 02/2015, si dhe në kuptim të nenit 115 paragrafi 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

### **Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**

**Anr.870/2021 më datën 06.11.2021**

**Kryesues i Panelit**

Adnan Konjusha

**Këshillë Juridike:** Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.

